

	KONKURS PUBLIK	DT-BNJ-027
	ver. 1.2	faqe 1 nga 4
Departamenti i Burimeve Njerëzore		Sektori i Personelit

Bazuar në nenin 8 të Ligjit të punës nr. 03/L-212 të Republikës së Kosovës, nenin 4 (paragrafi 1, 2, 3, 4, 5) dhe nenin 5 të Udhëzimit Administrativ 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik si dhe pikën 4.4, 5.1.1, 6.2 dhe 9.2 të Politikës së Rekrutimit, Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut-KOSTT sh. a. shpall:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e pozitave:

1 (një) Auditor për çështje ekonomike, ligjore dhe rregullative

1 (një) Auditor për çështje elektroenergjetike, mekanike dhe Implementim të projekteve

Kushtet e përgjithshme:

Kohëzgjatja e punësimit: Për kohë të pacaktuar

Në tekstin në vijim përdorimi e njëres gjini nuk përjashton gjininë tjetër.

Orari i punës: Puna me orar të plotë. Lartësia e pagës do të përcaktohet në harmoni me politikat e aprovuara të KOSTT-it.

Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën : Auditor për çështje ekonomike, ligjore dhe rregullative

Nr. referues i pozitës: 1.0.3.1

Detyrat e përgjithshme

Detyrë e përgjithshme e Auditorit për çështje ekonomike, ligjore dhe rregullative është të kontribuojë në përmirësimin sistemeve të menaxhimit financiar, ligjor, performances, dhe të kontrollit që veprojnë në KOSTT. Qëllimi i Auditorit për çështje ekonomike, ligjore dhe rregullative është që KOSTT-it ti ofroj siguri objektive në përmbushjen e objektivave, duke sjellë një qasje sistematike, të disiplinuar për vlerësimin dhe përmirësimin e efikasitetit të procesit në menaxhimin e rrezikut dhe të kontrollit.

Detyrat specifike:

- Të raportoj për aktivitetet audituese tek Zyrtari për Auditim të Brendshëm (Drejtori i Auditimit);
- Përgatitjen e planit për njësinë (departamentin) për auditim;
- Sigurimin e cilësisë së angazhimeve të auditimit;
- Përgatitjen e letrave të punës në lidhje me auditimin e kryer;
- Përpilimin dhe përgatitjen e nivelit të rreziqeve të cilat duhet ti kryej gjatë auditimit;
- Dhënia e rekomandimeve adekuate për njësinë- Departamentin e audituar;
- Kryerjen e auditimit të rregullsisë financiare, operative, ligjore, performancës, përcjelljes etj;
- Sigurimin e cilësisë së angazhimeve të auditimit;
- I zbaton detyrat dhe përgjegjësit sipas planë programit dhe kërkesave shtesë të cilat mund të delegohen nga ZAB;
- Përgatitjen dhe adaptimin e pyetësorëve sipas aktivitetit audituese;
- Nxjerrjen e mostrimit sipas gjykimit profesional ose metodave tjera relevante;
- Mbledhjen dhe analizën e të dhënave;
- Mbajtjen e takimit përmbyllës të auditimit;
- Përgatitjen e draft raportit dhe raportit të auditimit;

- Përcjelljen e implementimit të rekomandimeve të dhëna;
- Verifikimi i rregullt i përshtatshmërisë të cilat kanë për qëllim që të sigurojnë se dokumentacioni financiar, ligjor mbahet në përputhje me standardet, rregullat dhe ligjet përkatëse;
- Verifikimi i përshtatshmërisë dhe funksionimit të rregullt të sistemeve dhe procedurave të cilat e kanë për qëllim që të garantojnë zbatimin e ligjeve të aplikueshme në Kosovë.

Pavarësia:

- *Auditori për çështje ekonomike, ligjore dhe rregullative* duhet të jetë në gjendje që ta kryej punën e tij në mënyrë të pavarur dhe objektive. Të paraqet gjykim të paanshme dhe të drejtpërdrejt që janë me rëndësi esenciale për kryerjen e duhur të angazhimeve të auditimit të brendshëm.
- Në mënyrë funksionale, *Auditori për çështje ekonomike, ligjore dhe rregullative* i raporton Zyrtarit për Auditim të Brendshëm, që e siguron një nivel të lartë të pavarësinë e auditorit.

Autorizimet:

- *Auditor për çështje ekonomike, ligjore dhe rregullative*, ka të drejtë qasje në të gjithë lokacionin e KOSTT-it, në çdo lloj baze të të dhënave, dokumenti, fajlli, korrespondence, llogarie, dosje etj. të nevojshme për kryerjen e punës së tij/sajë.
- Me kërkesë të ZAB, secili punëtorë i Ndërmarrjes është i obliguar që të bashkëpunojë, mundësojë informacion të mjaftueshëm dhe sqarimet e nevojshme për kryerjen e aktiviteteve audituese të AB.

Standardet Profesionale:

- *Auditor për çështje ekonomike, ligjore dhe rregullative*, punën e vet e kryen në harmoni me Ligjin e Ndërmarrjes Publike, Manualin për Auditim të Brendshëm, Standardet profesionale të auditimit, Kodin Etik dhe Qeverisjen Korporative.

Të tjera

Kryen detyra të tjera të cilat kërkohen nga Menaxheri i Zhvillimit të Rrjeti dhe të cilat janë të nevojshme për funksionimin efektiv të KOSTT.

Kualifikimet, aftësitë dhe shkathtësitë tjera të Specialistit për çështje pronësore juridike:

Kandidatët/et përveç kushteve të përgjithshme të punësimit të cilat kërkohen me ligj, duhet ti plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:

- Diplomë universitare në ekonomi, juridik, administratë publike, ose financa publike;
- Të ketë së paku katër (4) vite përvojë pune profesionale në auditim nga momenti i përfundimit të studimeve në sektor publik dhe/ose privat në ndërmarrje ose organizata të madhësisë dhe kompleksitetit të ngjashëm me ndërmarrjen. Përvoja në auditim të projekte të financuara nga donatorët konsiderohet përparësi.
- Të jetë auditor i brendshëm i certifikuar sipas nenit 22 pika 2.2 të Ligji Nr.06/L-021.
- Certifikime të tjera në fushën e kontabilitetit, financave, dhe/ose auditimit nga shoqatat e njohura vendore dhe ndërkombëtare në fushën e sektorit publik konsiderohen përparësi.
- Të ketë njohuri të thellë nga fusha e sektorit publik, qeverisjes korporative dhe financiare;
- Nuk është i dënuar me aktgjykim të formës së prerë për kryerjen e veprës penale të dënueshme së paku gjashtë (6) muaj;
- Demonstrimi i aftësive të shkëlqyeshme për analizim dhe definim të problemeve, fakteve dhe për dhënie të rekomandimeve dhe konkluzioneve të bazuara në dëshmi;
- Demonstrimi i aftësive të shkëlqyeshme të komunikimit dhe të bashkëpunimit me menaxhmentin dhe stafin e Ndërmarrjes;
- Preferohet njohje e mirë e gjuhës angleze.

Kushtet e punës: Puna në zyre

Vendi/Lokacioni: Selia Qendrore e KOSTT-it

Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën:

Auditor për çështje elektroenergjetike, mekanike dhe Implementim të projekteve

Nr. referues i pozitës: 1.0.3.2

Detyrat e përgjithshme

Detyrë e përgjithshme e Auditorit për çështje elektroenergjetike, mekanike dhe implementimi të projekteve është që të kontribuojë në përmirësimin sistemeve të menaxhimit energjetik mekanik, implementim të projekteve, rregullativës energjetike, performances, dhe të kontrollit që veprojnë në KOSTT. Qëllimi i Auditorit për çështje elektroenergjetike, mekanike dhe implementim të projekteve është që KOSTT-it ti ofroj siguri objektive në përmbushjen e objektivave duke sjellë një qasje sistematike, të disiplinuar për vlerësimin dhe përmirësimin e efikasitetit të procesit në menaxhimin e rrezikut dhe të kontrollit

Detyrat specifike:

- Të raportoj për aktivitetet audituese tek Zyrtari për Auditim të Brendshëm (Drejtori i Auditimit);
- Përgatitjen e planit për njësinë (departamentin) për auditim;
- Përgatitjen e letrave të punës në lidhje me auditimin e kryer;
- Përpilimin dhe përgatitjen e nivelit të rrezeve të cilat duhet ti kryej gjatë auditimit.
- Dhënia e rekomandimeve adekuate për njësinë- Departamentin e audituar;
- Kryerjen e auditimit të rregullave energjetike mekanike, operative ligjore, performances, përcjelljes dhe implementimit të projekteve etj;
- Sigurimin e cilësisë së angazhimeve të auditimit
- I zbaton detyrat dhe përgjegjësitë sipas planë programit dhe kërkesave shtesë të cilat mund të delegohen nga ZAB;
- Përgatitjen dhe adaptimin e pyetësorëve sipas aktivitetit audituese;
- Mostrimin sipas gjykimit profesional ose metodave tjera relevante;
- Mbledhjen dhe analizën e të dhënave;
- Takimin përmbys në lidhje me auditimin e kryer;
- Draft raportin dhe raportin e auditimit
- Përcjelljen e implementimit të rekomandimeve;
- Verifikimi i rregullt i përshtatshmërisë të cilat kanë për qëllim që të sigurojnë se dokumentacioni elektronergjetik, mekanik dhe implementim të projekteve, mbahet në përputhje me standardet, rregullat, manualin dhe ligjet përkatëse;
- Verifikimi i përshtatshmërisë dhe funksionimit të rregullt të sistemeve dhe procedurave, të cilat e kanë për qëllim që të garantojnë zbatimin e ligjeve të aplikueshme në Kosovë.

Pavarësia:

Auditori për çështje elektroenergjetike, mekanike dhe implementimi të projekteve, duhet të jetë në gjendje që ta kryej punën e tij në mënyrë të pavarur dhe objektive. Të paraqet gjykim të paanshme dhe të drejtpërdrejtë, që janë me rëndësi esenciale për kryerjen e duhur të angazhimeve të auditimit të brendshëm. Në mënyrë funksionale, *Auditori për çështje elektroenergjetike, mekanike dhe implementimi të projekteve* i raporton Zyrtarit për Auditim të Brendshëm, që e siguron në nivel të lartë të pavarësisë.

Autorizimet:

Auditor për çështje elektroenergjetike, mekanike dhe implementimi të projekteve, ka të drejtë qasje në të gjithë lokacionin e KOSTT-it, në çdo lloj baze të të dhënave, dokumenti, fajlli, korrespondence, llogarie, dosje, programi etj. të cilat janë të nevojshme për kryerjen e punës së tij/sajë. Me kërkesë të ZAB, secili punëtorë i Ndërmarrjes është i obliguar që të bashkëpunojë, mundësojë informacion të mjaftueshëm dhe sqarimet e nevojshme për kryerjen e aktiviteteve audituese.

Standardet Profesionale:

Auditor për çështje elektroenergjetike, mekanike dhe implementimi të projekteve, punën e vet e kryen në harmoni me Ligjin e Ndërmarrjes Publike, Manualin për Auditim të Brendshëm, Standardët profesionalë të auditimit, Kodin Etik dhe Qeverisjen Korporative.

Kualifikimet, aftësitë dhe shkathtësitë tjera të Specialistit për çështje pronësore juridike:

Kandidatët/et përveç kushteve të përgjithshme të punësimit të cilat kërkohen me ligj, duhet ti plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:

- Të ketë diplomë universitare në Eelektroenergjetikë, Mekanike, Ndërtimtari ose ekuivalente.
- Të ketë së paku katër 4 vite përvojë pune profesionale në sektorin e sistemit elektroenergjetik ose në ndërmarrje të madhësisë dhe kompleksitetit të ngjashëm me ndërmarrjen. Përvoja në auditim në sektorin elektroenergjetik dhe auditim të projekteve konsiderohet përparësi.
- Të ketë njohuri të avancuara nga fusha e sektorit publik, qeverisjes korporative dhe energjetike;
- Nuk është i dënuar me aktgjykim të formës së prerë për kryerjen e veprës penale të dënueshme së paku gjashtë (6) muaj;
- Demonstrimi i aftësive të shkëlqyeshme për analizim dhe definim të problemeve, fakteve dhe për dhënie të rekomandimeve dhe konkluzioneve të bazuara në dokumente;
- Demonstrimi i aftësive të shkëlqyeshme të komunikimit dhe të bashkëpunimit me menaxhmentin dhe stafin e Ndërmarrjes;
- Preferohet njohje e mirë e gjuhës angleze.

Kushtet e punës: Puna në Zyre

Vendi/Lokacioni: Selia Qendrore e KOSTT-it

Forma e aplikimit për të gjitha pozitat e shpallura:

Të interesuarit mund të aplikojnë përmes internetit duke i plotësuar aplikacionet të cilat mund t'i shkarkojnë nga Web Faqja e KOSTT-it: www.kostt.com

E-mail adresa ku duhet të aplikohet është: punesimi@kostt.com

Aplikacionet do të pranohen vetëm nga kandidatët, të cilët i plotësojnë kërkesat e parashtruara si në konkursin publik të shpallur në mjetet e shkruara të informimit dhe në webfaqen zyrtare të KOSTT-it.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e diplomës së shkollimit si dhe kopjet e dëshmive tjera sipas kërkesave të konkursit.

Dokumentet origjinale të cilat i vërtetojnë faktet e theksuara në aplikacion duhet të prezantohen në momentin e intervistimit ose para intervistimit nëse kërkohen.

Selektimi i kandidatëve që plotësojnë kushtet e konkursit, testimi me shkrim, intervista, përzgjedhja dhe informimi i kandidatëve do të bëhen në përputhje me afatet dhe kriteret sipas udhëzimit administrativ për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik nr.07/2017.

Konkursi publik mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në mjetet e shkruara të informimit dhe në webfaqen e KOSTT, nga data 15.08.2023 deri më 29.08.2023 ora 24:00.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.

KOSTT ofron mundësi të barabarta të punësimit për gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës si dhe inkurajon kandidatët e gjinisë femërore dhe të rinjtë që të aplikojnë për këto vende pune.